



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| Eksperti Shqyrtues | Data e autorizimit të ekspertit | Date e dorëzimit të raportit | Nr. i lëndës |
|---------------------------|--|-------------------------------------|---------------------|
| Fatmir Krasniqi | 24.01.2024 | 31.01.2024 | 2024/0041 |

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 11.01.2024, OE Kompania E Sigurimit Fizik Scorpion, adresa Rr.Vellezerit Gervalla Ferizaj, ka parashtruar ankese me nr: 2024/0041, kunder njoftimit mbi vendimin e AK, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Sigurimi fizike e objekteveme nr. te prokurimit: 661-23-13525-2-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Ranillug. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: sherbim, vlerë e mesme, vlera e parashikuar e kontratës: **60,000,000€**. Konform nenit 113, 114 te Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore te OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 28 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 38 i Rregullores 001/2022

Neni 108A i LPP-së

KRITERET PËR VLERËSIM

Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Raporti i komisionit është i nënshkruar nga anëtarët e komisionit dhe me datë 27.12.2023 është ngritë në platformën elektronike Eprokurimi. Ku është rekoamnduar për kontratë SAS shpk si OE i përgjegjshëm me çmimin me te ulët.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

n/a

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Kompania E Sigurimit Fizik Scorpion**

Sqarim Hyrës

Autoriteti Kontraktues – Komuna Ranillug gjatë këtij aktiviteti ka aplikuar procedurën e hapur, vlerë e mesme, lloji i kontratës, shërbim vlera e parashikuar **60,000.00€**.

AK me dt 04.12.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt. 26.12.2023 dhe për këtë aktivitet prokurimi kishin aplikuar tre operator ekonomik në mesin e tyre edhe OE ankues.

AK- Komuna Ranillug me dt. 28.12.2023, ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-se ku për kontratë ka rekomanduar grupin e OE SAS shpk vlera e ofertës 56,790.53€. Ndërsa oferten e OE ankues komisioni e ka vlerësuar si ofertë e pasukseshme.

Kundërnjoftimit mbi vendimin e AK, pala ankuese fillimisht parashtron Kërkesen për Rishqyrtim tek AK brenda afatit ligjor. AK me dt. 04.01.2024 nxjerr vendim mbi refuzimin e kërkesës si të pa-bazuar. OE i pakënaqur me përgjigjen e AK-së me dt. 11.01.2024 paraqet ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) me pretendime të njëjta.

OE ankues, në ankesë ka paraparë dy pretendime ankimore të gjata, i pari ka të bëjë me çmimet e dhëna në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë duke pretenduar se ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme sepse ka ofertuar me tre numra pas presjes dhjetore dhe njëkohësisht korrigjimi nga ana e komisionit nuk është bërë në përputhje me LPP-në, dhe pretendimi i dytë me listën e stafit, duke pretenduar se lista e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit.

Përgjigje në Pretendimet e OE ANKUES

Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve/ dëshmive në platëformën e-prokurimi sa i përket pretendimit ankimor se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.2 të LPP-së kur ka rekomanduar për kontratë OE SAS shpk pasi që i njëjti është i papërgjegjshëm, sepse ka ofertuar me çmim jo të sakt, konsideroj se nuk qëndron. Kjo për faktin se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim prej 2 numrave pas presjes dhjetore konform nenit 17.11 të rregullores për prokurim publik.

Më tej eksperti sqaron se OE i rekomanduar për kontratë përveç se ka plotësuar përshkrimin e çmimit, i njëjti ka bashkangjitur me ofertë edhe analizën financiare të detajuar përmes të cilës vërtetohet se paga është 270.00€ neto për punëtor. OE ankues kur ka kalkuluar pagën në kalkulatorin e pagave ka përdorur çmimin e pagës bruto në vlerë prej 293.77€ kurse vlera e saktë sipas analizës financiare të dorëzuar me ofertë nga ana e OE të rekomanduar për kontratë është 293.82€ dhe nëse e vërtetojmë këtë shumë në kalkulator të pagave arrihet sakt paga minimale prej 270.00€ ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit.

Vlenë të ceket fakti se nëse i krahasojmë vlerësimet e bëra nga OE ankues, sa i përket çmimit të ofertës së tij dhe ofertës së OE të rekomanduar vërehet se te dy operatorët ekonomik në ofertat e tyre pagën bruto e kanë kalkuluar me çmimin e njëjtë në vlerë prej 293.82€ por dallimi qëndron tek kolona fitimi i kompanisë ku OE ankues ka paraparë fitim prej 0.07cent ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka paraparë fitim prej 0.01cent. Ky fakt edhe e bënë dallimin në mes të ofertave të dorëzuara kurse sa i përket fitimit të kompanisë mbetet në përgjegjësinë e tyre kalkulimi i fitimit. Prvovë me ekspertizë do të bashkngjes kalkulimin e OE ankues me çmim gabim prej 293.77€ dhe kalkulimin me çmim real sipas analizës financiare të OE të rekomanduar për kontratë.

Prova 1: Kalkulim i pagës bruto të OE të rekomanduar për kontratës sipas OE ankues me çmim prej 293.77€

Prova 2: Kalkulimi i pagës sipas çmimit real të paraqitur ne analizën financiare se bashku me ofertë të OE të rekomanduar për kontratë.

Siç po vërehet edhe nga provat e bashkangjituara me ekspertizë, OE ankues kur ka kalkuluar pagën bruto të OE të rekomanduar për kontratë ka aplikuar çmimin prej 293.77€ i cili çmim nuk është në analizën financiare të OE të rekomanduar për kontratë. Pas kalkulimit të pagës bruto sipas vlerës së sakt të paraqitur në analizën financiare të OE të rekomanduar për kontratë vërehet se OE ka kalkuluar sakt pagën bruto në vlerë prej 293.82€ me ç'rast është përmbushur kriteri i dosjes së tenderit që paga për punëtor të jetë minimum 270.00€.

4

kontratë për ndryshim të çmimit të ofertës përmes të ciles oferta e OE ankues kishte ndryshuar për një cent në mes të asaj të ofertuar me atë të korrigjuar. Marrë parasysh se ndryshimi i çmimit ishte minor dhe në përputhje me nenin 59.3 të LPP-së, pra nën 2% të vlerës së lejuar, konsideroj se AK ka vepruar në përputhje me nenin 59.3 LPP-së kur ka korrigjuar çmimin e ofertës së OE të rekomanduar për kontratë dhe nga i njëjti kanë pranuar deklaratën e pajtueshmërisë së ndryshimit të çmimit. Andaj , **vlerësojmë se pretendimi i palës në ankesë se OE i rekoamduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse ka ofertuar çmim jo të sakt dhe me tre numra pas presjes dhjetore, është i paqëndrueshem.**

OE ankues në pretendimin e dytë, kundërshton ofertën e OE të rekomanduar për kontratë sa i përketë listës së stafit duke pretenduar se i njëjti nuk ka dorëzuar listën sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Lidhur me pretendimin e dytë ankimor Eksperti Shqyrtuesqaron se, bazuar në analizën e fakteve/ dëshmive në platëformën E-prokurimi, AK për këtë aktivitet të prokurimit në dosje të tenderit tek kërkesat teknike dhe profesional 9.1&9.2 kishte kërkuar si në vijim;

Kërkesa;

Lista e punëtorëve për realizimin e projektit

Dëshima e kërkuar;

Lista e punëtorëve minimalisht 13 për zbatim projekt i nënshkruar dhe i vulosur.

OE i rekomanduar për kontratë nga AK, SAS shpk për ta përbushur kriterin e dosjes së tenderit kishte dorëzuar listën e stafi prej 13 punëtorëve të nënshkruar dhe vulosur si në vijim;



Lista e punëtorëve SAS SHPK

| Nr. | Emri Mësimi | Nr.Personal | Posita |
|-----|---------------------|-------------|--|
| 1 | Don Dajçi | 100235084 | Menaxher Operativ i mbrojtjes së afërt - Drejtor |
| 2 | Skender Bllaca | 101325072 | Menaxher i sigurimit dhe shërbimeve CIMA |
| 3 | Herat Hysoni | 2012414687 | Menaxher i sigurimit dhe shërbimeve |
| 4 | Arben Vllasi | 1138825132 | Sigurimi dhe shërbimeve |
| 5 | Alban Mahmuti | 1031146819 | Sigurimi dhe shërbimeve |
| 6 | Faton Bllaca | 117483860 | Sigurimi dhe shërbimeve |
| 7 | Haki Kotalani | 101293029 | Sigurimi dhe shërbimeve |
| 8 | Zija Salihu | 100503281 | Sigurimi dhe shërbimeve |
| 9 | Vladimir Marini | 1241408022 | Sigurimi dhe shërbimeve |
| 10 | Enkë Hoxhani | 125802058 | Sigurimi dhe shërbimeve |
| 11 | Alban Sadiku | 2013051873 | Sigurimi dhe shërbimeve |
| 12 | Murat Sadiku Vukoli | 103080741 | Menaxher i sigurimit dhe shërbimeve |
| 13 | Beirani Abasi | 1013149697 | Sigurimi dhe shërbimeve |

SAS shpk - Gjilan



Eksperti shqyrtues sqaron se, AK në dosje të tenderit nuk kishte specifikuar as profesione të stafit apo kualifikim të caktuar, por kishte caktuar vetëm numrin minimal prej 13 punëtorëve dhe kushtin që lista të jetë e nënshkruar dhe vulosur. Siç vërehet OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listën e stafit prej 13 punëtorëve dhe poashtu është e vulosur dhe nënshkruar.Pra, konsideroj se e njëjta është në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit. Andaj, **vlerësojmë se pretendimi i palës në ankesë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar listën e stafit sipas kërkesës së dosjes së tenderit është i paqëndrueshme.**

Si përfundim Eksperti Shqyrtues sqaron se, AK nuk kishte nxjerr vendim për pezullimin e aktivitetit të

prokurimit ashtu siç e kërkon dispozita e nenit 108A pargrafi 2 i LPP-së “*Dorëzimi i një kërkesë për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar*”. Ky pretendim ankimor i pales në ankesë është pjesërisht i qëndrueshëm, por meqenëse AK nuk ka ndërmarr asnjë veprim tjetër pas pranimit të ankeses. Andaj, konsideroj se nuk ka prodhurar ndonjë efekt negativ në procedurë mos nxjerrja e vendimit mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit, për faktin se AK e trajton si të pezulluar tashmë. Eksperti shqyrtues po ashtu sqaron se mbetet në përgjegjësi dhe diskercion të Autoritetit kontraktues respektivisht zyrtarit përgjegjës të prokurimit ZPP zbatimi i të gjitha dispozitave ligjore të parapara në LPP.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Kompania E Sigurimit Fizik Scorpion**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Sigurimi fizike e objekteve**” me numër të prokurimit: “**661-23-13525-2-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA RANILLUG**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA RANILLUG**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Kompania E Sigurimit Fizik Scorpion**

Fatmir Krasniqi

